

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.A., nga fshati ..., Komuna e Istogut, kundër të paditurës Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson me autorizim H.I., avokat nga Peja, për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të t'paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.768/12, i datës 16.09.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 07.04.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të t'paditurës Komuna e Pejës, VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.768/12, i datës 16.09.2013, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset ashtu që: DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 16.09.2013, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit S.A. nga fshati ..., Komuna e Istogut, me të cilën është detyruar e paditura Komuna e Pejës, që paditësit ti paguaj në emër të kompensimit të ardhurave personale për pagat e pa paguara për muajt Gusht, Shtator, Tetor të viti 2011, dhe gjysmës së pagës për muajin Nëntor të vitit 2011, ndërsa nga muaji nëntor i vitit 2011, e gjer në muajin Shtator të vitit 2012, diferencën e pa paguar në përputhje me kualifikimin e tij profesional, shumën në total prej 2.255 Euro, me kamatë në lartësi prej 4%, në nivel vjetor, nga dita e ushtrimit të padisë datë 03.10.2012, e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 156 Euro, e gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të autorizuarit të t'paditurës ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

Ankesa e të autorizuarit të t'paditurës i është dorëzuar paditësit për përgjigje por i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të t'paditurës është e pabazuar, përveç sa i përket kamatës.

Gjykata e shkallë së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit S.A., nga fshati ..., Komuna e Istogut, kundër të paditurës Komuna e Pejës, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka marrë aktgjykimin e atakuar. Në procedurën e të provuarit ka administruar prova dhe ka vërtetuar gjendjen faktike sipas të cilës është vërtetuar se paditësi në cilësinë e punëmarrësit dhe e paditura në cilësinë e punëdhënësit kanë lidhur kontratën e datës 01.12.2010, sipas të cilës paditësi pranë të paditurës është përcaktuar në kryerjen e detyrave të punës si mësimdhënës i lëndëve ekonomike në Shkollën e Mesme "Ali Hadri" në Pejë. Paditësi me kërkesën e datës 08.10.2010, i është drejtuar të paditurës që ti lejojë pushim pa pagesë për 10 muaj me arsyetim se i njëjti kishte probleme shëndetësore dhe gjendet për shërim jashtë vendit. E paditura me aktvendimin nr. 738/68 të datës 08.10.2010, i'a lejon pushimin pa pagesë paditësit duke filluar nga data 08.10.2010, e deri me datën 08.08.2011. Paditësi me datë 08.08.2011, është paraqitur në vendin e tij të punës, mirëpo të njëjtit nuk i janë paguar pagat për muajt Gusht, Shtator, Tetor dhe gjysma e pagës së muajit Nëntor të vitit 2011, ndërsa nga muaji Nëntor i vitit 2011 e gjer në muajin Shtator të vitit 2012, nuk i është paguar paga si mësimdhënës sipas kontratës së punës. Nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura në cilësinë e mësimdhënësit te lëndëve ekonomike në Shkollën e Mesme "Ali Hadri" në Pejë, dhe i njëjti ka realizuar pagë mujore bruto në shumë prej 436 Euro, kurse pas kthimit të tij nga pushimi mjekësor pa pagesë në vendin e tij të punës, të njëjtit nuk i janë paguar pagat për muajt kontestuese, ndërsa nga muaji Nëntor i vitit 2011, e gjer në muajin Shtator të vitit 2012, nuk i është paguar paga në përputhje me kualifikimet e tija profesionale si mësimdhënës i certifikuar dhe me përgatitje superiore shkollore, siç është e rregulluar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar. Kontestuese nuk ka qenë se lartësia e shumës se pagave të papaguara dhe diferencës për muajt kontestues në lartësi prej 2.255 Euro dhe atë për 3 pagat e pa paguara nga 436 Euro, në total prej 1.309 Euro, për gjysmën e pagës së muajit Nëntor shumen prej 218 Euro, ndërsa prej muajit Nëntor të vitit 2011 e gjer në muajin Shtator të vitit 2012, nga 81 Euro, për muaj, në përputhje me kualifikimin e tij profesional si mësimdhënës i licencuar, në total prej 729 Euro. Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë e aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, rrjedhimisht edhe i përshtatshëm për përmbartim, pasi që e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës është i përcaktuar mjaftë qartë. Gjykata ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestuese duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie. Pretendimi ankimor i të paditurës është një përshkrim, fjalë për fjalë i dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pa dhënë arsyeje specifike se cilat të meta të dispozitivit apo të arsyetimit përbëjnë shkelje, prandaj Gjykata e Apelit nuk e ka pranuar një pretendim të tillë.

Lidhur me pretendimin për gjendjen faktike Gjykata e Apelit vlerëson se një pretendim i tillë është i pa bazuar pasi që nga përgjigja në padi e të paditurës e datës 08.05.2013, dhe nga deklaratimet e të autorizuarit të të paditurës në seancën e datës 12.06.2013, rezulton se e paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë sa i përket bazës juridike duke pretenduar se kërkesëpadia është e pa bazuar, por nuk e ka kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë. As në seancën e datës 16.07.2013, kur është deklaruar i autorizuari i të paditurës lidhur me precizimin e kërkesëpadisë, i autorizuari i të paditurës nuk e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesës por e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë. Nga kjo rrjedh se lartësia e kërkesëpadisë për periudhën e gjykuar nuk ka qenë një fakt i kontestuar. Është në vlerësimin e gjykatës në kuptim të dispozitës së nenit 319 paragrafi 3 të LPK-së, se cilat prova do të marrë me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare, por nevoja për marrjen e provës diktohet nga rëndësia e faktit që duhet të provohet dhe nga deklarimi i palëve nëse ai fakt është i kontestueshëm. Kur fakti rezulton se është i pa kontestueshëm pavarësisht rëndësisë së tij atëherë gjykata nuk merr provë, përveç përjashtimeve nga neni 3 paragrafi 3 të LPK-së.

Si bazë për ankesë e paditura i është referuar edhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale por një pretendim të tillë nuk e ka arsyetuar.

Gjykata e Apelit sipas dispozitës së nenit 194 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale edhe në rastin kur nuk është pretenduar. Lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që faktet e çështjes janë kualifikuar në mënyrë të duhur në raport me normat materialo-juridike nga ku ka rezultuar si e themeltë bazueshmëria e kërkesëpadisë për mbrojtje gjyqësore me përmbajtje si në dispozitivin e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 262 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ligj i aplikueshëm në kohën kur janë krijuar raportet, e cila përcakton se *“Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje sikundër është përmbajtja e tij”*. Me qenë se me provat e administruara ka rezultuar se e paditura nuk i ka paguar paditësit të ardhurat personale për tre muaj, për një muaj gjysmën e pagës dhe diferencën e shumës se pagave të papaguara në përputhje me kualifikimet e paditësit nga 81 Euro, në muaj duke filluar nga muaji nëntor 2011 e deri në muajin shtator 2012, atëherë në kuptim të dispozitës së cituar përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar. Në këtë rast është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e nenit 277 e LMD-së, pasi që kamata nuk është përcaktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3647/2013 të datës 07.04.2016

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Albert Zogaj. d.v.